



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

E K S T R A K T

Nga procesverbali i mbledhjes së 15-të të Kuvendit të Komunës së Lipjanit mbajtur më
07. 04. 2015 në sallën e Kuvendit me fillim në ora 10⁰⁰

Në mbledhje prezentuan:

1. Vlora Limani-Hajnuni, Kryesuese
2. Labinot Shahini, anëtar
3. Nehat Tërpeza, anëtar
4. Daut Azemi , anëtar
5. Agron Hajdini, anëtar
6. Arton Retkoceri, anëtar
7. Naim Jahiri, anëtar
8. Burbuqe Fazliu, anëtar
9. Linda Shahini, anëtar
10. Xhevat Olluri, anëtar
11. Rizah Bajraktari, anëtar
12. Ukë Kryeziu, anëtar
13. Merita Zeqiri-Hajrizi, anëtar
14. Hajrije Salihu, anëtar
15. Blerim Gashi, anëtar
16. Adelina Krasniqi, anëtar
17. Florent Hoxha, anëtar
18. Petrit Kelmendi, anëtar
19. Ragip Zejnullahu, anëtar
20. Nazmi Krasniqi anëtar
21. Enver Kozhani, anëtar
22. Feriz Hasani, anëtar
23. Valbona Shillova, anëtar
24. Vlora Buja, anëtar
25. Arben Bahtiri, anëtar
26. Edita Gashi, anëtar
27. Ramiz Qeriqi, anëtar
28. Zoran Çirkovic anëtar
29. Xhavid Maholli, anëtar

Të tjerë prezent:

1. Rasim Hasani, Drejtor i arsimit
2. Remzi Mehmeti, DMSH
3. Basri Hashani, Drejtor i DKRS
4. Avdullah Fazliu, Drejtor i Shëndetësisë
5. Heset Sahiti, Drejtor i Sherbimeve Publike
6. Imer Rustemi, Drejtor i Inspektionit
7. Ilir Tasholli, Drejtor i Urbanizmit
8. Fauz Xhemajli, Drejtor i Administra
9. Behar Krasniqi, zyra ligjore
10. Kimete Jashanica, përfaqësuese e OSBE-së
11. Bekim Krasniqi, "YAHR"
12. Përfaqësuesi i OJQ "Ballkan"
13. Alban Nuredini, Zëdhënës i Komunës
14. Përfaqësuesit e mediave
15. Naser Bytyqi-përkthyes, shqip-serbisht
16. Rifat Hoxha-perkthyes, shqip-serbisht

Proqesverbalin nga kjo mbledhje e mbajti **Sami Murati**.

Kryesuesja e Kuvendit, Vlora Limani-Hajnuni, pas konstatimit se në mbledhje prezentojnë shumica e anëtarëve të Kuvendit dhe se ekziston kuorumi për punë dhe vendosje të plotëfuqishme hapi mbledhjen duke përshëndetur të pranishmit.

Pastaj tha se para se të kalojmë në rendin e ditës j'u njoftoi se në vend të Albulena Gashit kemi anëtarën e re Adelina Krasniqi të cilën e ftoi që të jep betimin. Pastaj Adelina Krasniqi, lexoi deklaratën solemne të betimit. Në vazhdim Kryesuesja njoftoi Kuvendin se Adelina në Komitetin për Bujqësi dhe Pylltari dhe në Komisionin për zgjedhjen e Këshillave të fshatrave ndërsa Blerim Gashi caktohet në Komitetin Konsultativ për Shërbime Publike.

Merita Zeqiri, kërkoi që Kuvendi me një minut heshtje të nderoi nënën Ajshe Qeriqi e cila dje ka ndërruar jetë dhe që gjatë luftës ka dhënë kontribut të madh dhe ka ndihmuar UÇK-në.

Në vazhdim Kryesuesja, kërkoi nga të pranishmit që të ngriten në këmbë dhe t'i bëjnë nderim me një minutë heshtje.

Pastaj Kryesuesja, pyeti anëtarët se a ka dikush vrejtje apo plotësime në rendin e ditës?

Basri Hashani, Drejtor i Drejtoratit për Kulturë Rini dhe Sport, kërkoi që pika e 4-të të hiqet nga rendi i ditës.

Me që vërejtje të tjera nuk pati Kryesuesja, vuri në votim rendin e ditës me propozimin e drejtorit për heqjen e pikës së 4-të dhe pas votimit konstatoi se Kuvendi me shumicën e votave për punën e kësaj mbledhje aprovoi këtë :

REND DITE

1. Aprovimi i ekstraktit nga mbledhja e 15-të e KK-së
2. Propozim Vendimi për ndryshimin dhe plotësimin e Statutit të Komunës 1Nr.110-623 i datës 26.09.2008,
3. Propozim Vendimi për miratimin e Memorandumit të Mirëkuptimit për Bashkëfinancim në Implementimin e Projektit – Rregullimi i Hapsirave Publike në Qytetin e Lipjanit.

Pastaj Kryesuesja, pyeti anëtarët e Kuvendit, se a ka dikush të thotë diqka para se të kalojmë në punë sipas rendit të ditës së aprovuar?.

Florent Hoxha, kërkoi që rruga për fshatin Divjakë të shtrohet dhe se ne e kemi vizituar këtë fshatë dhe se kjo rrugë është në gjendje shumë të keqe dhe gjithashtu kjo është kërkesë edhe e banorëve të fshatit Divjakë. Gjithashtu tha se në rrugën “Qamil Olluri” para një viti është hapur një gropë nga kompanija e “Ujësjiellit” andaj kërkoi, nga Drejtori i Drejtoratit për Shërbime Publike, që të shiqon mundësin e rregullimit, me që automjetet po pësojnë në ato rrugë.

Ramiz Qeriqi, tha se kemi qenë në një trajnim, të cilin e ka organizue shoqata “Helvetija” dhe aty kam parë se nga këto trajnime përfiton shoqata “Helvetija” dhe Hoteli me që gjatë drekës në tavolin vishin 4 ushqime edhe pse aty ishim ulur vetëm dy vetë.

Vlora Limani, Kryesuese e Kuvendit, tha se për këto trajnime, kemi bisedue me Kryetarin, nga se shumë qka mund të mësojm nga këto trajnime. Në vazhdim tha se para se me shkue në këto trajnime është mirë që të keni para vetës Rregullorën e Punes së Kuvendit, Statutin dhe Ligjin për Vetqeverisjen Lkale dhe se nëse ata trajner parqesin diqka në kundërshtim me këto atëher mos i pranoni. Sa i përket shpenzimeve që i përmendi z. Qeriqi këtë shoqatë e financon Qeverija e Zvicrrës dhe une nuk besoj se kjo Qeveri lejon këtë shoqatë që të bëjë keqpërdorimin e mjeteve.

Blerim Gashi, ne jemi të zgjedhurit e popullit dhe këtu i bartim kërkesat e qytetarëve dhe në mbledhjen e kaluar ka qenë një kërkesë që në rend dite të hynë për shqyrtim procesi i legalizimit për objekte kurse sot kjo pikë nuk është në rend dite. Pytja ime e dytë është që qështja e objektit për raste sociale, i cili është dhënë me koncesion qe 4 vite, ne ende nuk dim se qka është bërë me këtë objekt bile ka qenë i informuar edhe komisioni për ndarjen e banesave. Pytje tjetër është që në fillim të vitit ka filluar procesi për zgjidhjen e problemit të qenëve endacak e që edhe për këtë qështje nuk dim se qka është bërë.

Vlora Limani-Hajnuni, Kryesuese e Kuvendit, këto pyetje Blerim i keni parashtrur edhe në KPF dhe unë nuk mundem të ju jap menjëher përgjigjeje edhe mos pritni gjatë mandatit tim të merrni menjëher përgjigjeje për këso pyetje me që këto qështje janë të rregulluara me Rregulloren e Punës së Kuvendit.

Merita Zeqiri, paraqiti shqetësimin e saj për mungesën e vijave të bardha nëpër rrugët e fshatrave, gjithashtu kërkoi që të shqyrtohet mundësia e shtruarjes së trotuarëve për fshatrat Topliqan i Vjetër, Hallaqi i Madh, Hallaq i Vogël, Rufci i Ri, Gllgovc dhe Ribari i Vogël. me që në këto rrugë është qarkullim i madh i automjeteve dhe është rrezik për udhëtar. Pastaj kërkoi nga drejtori i arsimit që të ndërpritet bashkëpunimi me RTK-në me programin 1.2.3 “Fillo” me që kemi vërejtur shumë padrejtësi në atë emision, ku nxënësve nga Gjakova një natë më parë ju janë dërguar pyetjet kurse nxënësit tonë nuk i kanë pasur këto pyetje.

Daut Azemi, unë kamë 2 pyetje, e para është për shkollën “Ismail Luma” ku të gjithë jemi dëshmitarë se pas gjdo reshjeje, kjo shkollë vërshohet, andaj pyesë se qfar masa janë marrë nga drejtoria? pyetje e dytë është për rrugën Lipjan- Janjevë deri në kryqë është shkatërruar edhe unë e di që kjo është rrugë regjionale por pyes a mundet Komuna që ta rregulloi këtë rrugë.

Enver Kozhani. në legjislaturën e kaluar, pyetjet të cilat janë parashtruar me shkrim, Kryesuesi në bashkëpunim me drejtorët, i kanë kthyer përgjigjet, kurse tani nuk ka përgjigjeje. Pastaj për meditet të cilat naj keni ndal keni biseduar me Florentin dhe keni premtuar se do ti paguani në këtë muaj dhe prap pagesa nuk është kryerë.

Vlora Limani-Hajnuni, kryesuese lidhur me parashtrimin e pyetjeve nga ana e delegatëve si dhe lidhur me përgjigjejet të cilat kërkojnë ju njoftoi se kto qështje janë të rregulluara me nenin 29 të Rregullores së punes së Kuvendit dhe në vazhdim lexoi nenin 29 të Rregullorës. Sa i përket pyetjes së Enverit lidhur me pagesën unë nuk jam kompetent me që këto punë i kryen Sektori për Punë të Kuvendit, ata e kanë evidencën e prezences dhe i përgadisnin raportet për pagesat e mediteve

Enver Kozhani, ne nuk pajtohem me përgjegjëjen tuaj me që ne kemi ardh në mbledhje dhe kemi nënshkrue në regjistrin e prezencës dhe arsyet dihen pse kemi dal nga mbledhja.

Vlora Limani-Hajnuni, Kryesuese, qështja se a pajtoheni a nuk pajtoheni është e juaja dhe mund ti ndiqni procedurat.

Nehat Tërpeza, unë po e përcjelli shqetsimin e banorëve të fshatit Bregu i Zi për shkak të mosfunksionimit të kanalizimit ku ujrë e zeza kanë dalë në sipërfaqe dhe shkaktojnë dëme. Gjithashtu kanë kërkuar që të bëhet zhavorimi i rrugëve në fshat.

Zoran Qirkoviq, kërkoi që mundësisht të bëhet zhavorimi i rrugës para Shkollës Fillore, Vëllëzërit Aksiq”.

Feriz Hasani, kërkoi që të shqyrtohet mundësia e rregullimit të shtretërve të lumenjëve të cilët gjatë të reshurave vërshojnë dhe mundësisht me rishikim të buxhetit të parashihen mjete për këtë qështje. Sa i përket vërshimeve të shkollës “Ismail Luma” kjo ndodhë me që uji kthehet përmes kanalizimit të oborrin e shkollës gjithashtu shkollës është në nivelin e rrugës.

Nazmi Krasniqi, për ndërtimin e kësaj shkolle ka pas procedura të gjata, sa i përket vërshimeve që po bëhen kjo ndodhë për shkak se afër “sitnices” është mbyllë me dhe, kontinjerët janë vendosur që disa muaj në qytet, dhe janë jashtë funksionit, sa i përket trotuareve lirisht po them se nuk janë punuar si duhet.

Sa i përket qështjes që foli Merita për ndërprerjen e bashkëpunimit me RTK-në lidhur me garat e nxënësve unë nuk kisha thënë që të ndërpriten këto gara.

Arben Bahtiri, kam pyetje për drejtorin e arsimit, me që edhe në mbledhjen e kaluar pyeti Blerimi për shkollën e re të gjimnazit kur do të përfundon dhe atë ditë përgjegjëja ishte se mbrenda muajit dhe unë nuk po shoh se është duke u punuar aty dhe nuk besoj se do të përfundon deri në shtator për shkollën fillore në Kraishtë, Glogovc dhe Banullë nuk e dim se deri kur kanë vajtur punët, nga Drejtori i Drejtoratit për Kulturë Rini dhe Sport kërkoi që në të ardhmen të ketë aktivitete më të mëdha me klube sportive me që po mungojnë rezultatet a dihet që sportistët janë ambasador të Komunës.

Edita Gashi, pyeti se çka është bërë me kërkesën time për zavendësimin e anëtarit në KPF

Vlora Limani-Hajnuni, unë kam lexuar kërkesën tuaj dhe Kuvendi duhet të vendosë por kërkesa ka arritur pas dërgimit të materialit për këtë mbledhje të Kuvendit.

Heset Sahtit, janë një grup pyetjesh do të mundohem të ju përgjigjem. Sa i përket pyetjes për fshatin Divjakë ju njoftoi se kjo rrugë ka qenë e planifikuar me buxhet për vitin 2014 dhe kanë qenë të planifikuara 100.000,00 euro por këto mjete i ka tërheq thesari për shkak të borgjeve që i kemi pas gjithashtu tha se këtë rrugë e ka zhavorue “Kfori Turk”. Në rrugë “Qamil Olluri” shpeshherë intervenohet nga “Kompanija e Ujësjetës” dhe gjatë intervenimit dëmtohet rruga por do të shiqojmë mundësinë e meremetimit. Sa i përket trotuareve që kërkoi Merita ne e dim se është nevojë por mundësitë nuk janë. Për kanalizimin për Bregun e Zi do të shiqojmë me lidhje me Bujari. Për zhavorimin e rrugëve kemi kërkesën nga Kryetari që të evidentohen se cilat rrugë kanë nevojë të zhavorohen. Për kontinjerët nëntoksorë është bërë një punë e mirë por kompanija nuk ka mekanizëm për tërheqjen –shkarkimin e tyre por ka shpall tenderin për këtë mekanizëm dhe së shpejti do të funksionalizohen këta kontinjerë. Për trotuare ndoshta do t’i tërheqim këto kubëza. Sa i përket rrugës për Janjevë ne kemi bërë kërkesë disa herë në Ministri por për shkak të mjeteve nuk është intervenu.

Rasim Hasani, Drejtor i Drejtoratit për Arsim, sa i përket kufizit “123 Fillo” ne në mënyrë zyrtare do të kërkojmë sqarim, unë mendoj se ne nuk mund të ndalojmë shkollat që mos të marrin pjesë në këtë garë me që shkollat vetë vendosin për këtë garë. Sa i përket shkollës “Ismail Luma” është mirë që u ndërtue kjo shkollë por nuk është dashtë që të ndërtohet në këtë vend me që të vjetrit e din se gjdo herë është vërshue ajo pjesë. Pastaj tha se shkollës nuk ka pas kanalizim nuk ka pas rrugë dhe këto i kemi kryer ne tani do ta bëjmë edhe rrethojnë. Sa i përket përfundimit të Gjimnazit ne nuk mund të themi azgjë me që nuk kemi qasje me që shumë herë jemi mashtruar nga ministrit dhe tani nuk guxojmë të themi se kur do të përfundojë. Sa i përket shkollave të tjera është duke u punuar ndërsa për Shkollën në Banullë është bërë kërkesa për pranim.

Ilir Tasholli, lidhur me procesin e legalizimit ne jemi të gatshëm të raportojm se edhe unë kam qenë pjesë e Kuvendit dhe se këtu përcillen kërkesat e qytetarëve. Pastaj tha se kemi bërë kërkes në MAPL për “Lumin Sitnica” e gjithashtu do të konkurojm edhe në projektet e Bankës Botërore.

Florent Hoxha, në mandatin e kaluar Shkolla “Ismail Luma” ka qenë e parapar me planin urban dhe reagimi i jonë ka qenë që themelet e kësaj shkolle të ngriten sa më lartë. Sa i përket projektit të lumit “Sitnica” projekti është i gatshëm dhe kushton mbi 10.000.000,00 euro.

Petrit Kelmendi, besoj se deri në muajin shtator objekti i Gjimnazit do të përfundoj ndërsa sa i përket rrugës së Janjevës dhe rrugës deri te udhëkryqi për Shtime kam bërë kërkesë në Ministri që të parashifet me buxhetin e vitit të ardhshëm.

Me që pyetje të tjera nuk pati u kalua në punë sipas pikës së parë të rendit të ditës

I

Aprovimi i ekstraktit nga mbledhja e 14-të e KK-së

Lidhur me këtë pikë Kryesuesja, Vlora Limani-Hajnuni pyeti anëtarët se a ka dikush vërejtje apo plotësime në ekstraktin nga procesverbali i mbledhjes së 14-të të Kuvendit?

Florent Hoxha, diskutimet tona lidhur me raportin e Kryetarit nuk janë përfshi edhe pse ne e kemi dorëzuar me shkrim fjalën e përgaditur ndërsa shumica e diskutimeve të anëtarëve të tjerë janë përfshi në ekstrakt andaj kërkoi që në të ardhmen së paku 50% të diskutimeve të përfshihen se unë e di që nuk ka mundësi të përfshihen të gjitha.

Vlora Limani-Hajnuni, nuk po du me ju kundërshtu dhe ndoshta keni të drejt, por unë po ju lejoj me diskutu nga gjysëm ore a dihet se e drejta e fjalës e shefave te grupeve parlamentare është nga 5 minuta, andaj nuk kam për qëllim ta mbroj procesmbajtësin se as që kam bisedu por është e pa mundur që të përfshihen të gjitha diskutimet që zgjasin nga gjysëm ore a dihet që të drejtën e fjalës shefat e grupeve parlamentare e kanë nga 5-10 minuta, andaj është mirë që pytet ti specifikoni dhe ti parashtroni në mënyrë konkrete.

Nehat Tërpeza edhe une kam vërejtje në procesverbal se përveq 3 anëtarëve të PDK-së edhe diskutimi i im nuk është përfshi.

Me që vërejtje të tjera nuk pati, Kryesuesja vuri në votim ekstraktin dhe pas votimit konstatoi se Kuvendi me 16 vota për 6 apstenime

Aprovoi

Ekstraktin nga procesverbali i mbledhjes së 13-të të Kuvendit me vërejtjet

Shtesë: Ekstrakti.

II

Propozim Vendimi per ndryshimin dhe plotësimin e Statutit të Komunës 1Nr.110-623 i datës 26.09.2008

Lidhur me këtë pikë Kryesuesja e Kuvendit Vlora Limani-Hajnuni. i dha fjalën Fauzë Xhemailit, Drejtor i Drejtoratit për Administratë i cili në vazhdim njoftoi me të dhënat nga propozim vendimi si dhe me propozimin e KPF-së për plotësimin e këtij vendimi me ndryshimin e emërimit të emrit të ZLK-së me emërtimin ZKK (Zyra Komunale për Komunitete) siq është e paraparë me rregullorën e Qeverisë

Pastaj Kryesuesja, Vlora Limani-Hajnuni, hapi shqyrtimin

Labinot Shahini, ndëgjuam drejtorin dhe kjo është qështje teknike, me që këto fshatra tani veq janë me Komunën e Graçanicës dhe nuk i paguajnë taksë Komunës tonë.

Florent Hoxha, ne kemi shqyrtuar këtë vendim në grupin parlamentar të PDK-së e gjithashtu edhe në KPF dhe dihet se neve nuk na ka pyetur askush edhe pse kemi kundërshtu dhe se kjo pjesë është ndarë sipas zonave kadastrale e gjithashtu tha se me Ligj fshati Skullan është me Komunën tonë.

Edita Gashi, qëndrimi i im është kundër këtij vendimi se ne kemi qen edhe kundër decentralizimit mirëpo nuk na ka pyetur askush.

Vlora Limani-Hajnuni, Kryesuese, tha se deshtëm apo sdeshtëm kjo është punë e kryer dhe kjo teknikisht duhet mu ndryshu.

Blerim Gashi, është një proces që ka ndodh dhe koncesionet i janë bërë komunitetit serb dhe është bërë ndarje etnike dhe neve nuk na ka pyetur askush. Edhe një her po e them se ky është koncesioni më i dëmshëm për neve por kjo ka qenë kërkesë e ndërkombtarëve.

Agron Hajdini, unë po e paraqes kërkesën e qytetarëve të fshatit suhadoll të “Lagjes së Hashanëve” të cilët kan kërkuar që të shqyrtohet mundësia që kjo lagje të mbetet me Komunen e Lipjanit me që edhe gjeografikisht jemi në kufi me Komunen e Lipjanit edhe pse ne të gjithë e dim se kjo ndarje është bërë me Pakon e Ahtisarit dhe ne nuk mund ta ndryshojm

Feriz Hasani, ne e dim që lagjësja e hashanëve gjeografikisht është me Komunen e Lipjanit andaj pyes se si ka mund me shkue me Komunen e Graçanicës.

Me që diskutime të tjera nuk pati, Kryesuesja, vuri në votim propozim vendimin me plotësimin edhe të nenit 46 të Statutit për riemërtimin e ZLK-së dhe pas votimit konstatoi se Kuvendi me 20 vota për, 4 kundër nuk aprovoi propozimin e vendimit me që për aprovimin e këtij vendimi duhen së paku 21 vota.

III

Propozim Vendimi për miratimin e Memorandumit të Mirëkuptimit për bashkëfinancim në implementimin e projektit – rregullimi i hapësirave publike në Qytetin e Lipjanit

Lidhur me këtë pikë, Kryesuesja e Kuvendit, Vlora Limani-Hajnuni, i dha fjalën Ilir Tashollit ,Drejtor i DPU-së i cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozim vendimi i cili vendim është pjesë përbërëse e procesverbalit.

Pastaj Kryesuesja hapi shqyrtimin

Petrit Kelmendi, është mirë që ka donator, për rregullimin e kësaj pjese të rrugës, mirëpo ka qen mirë që paraprakisht ta kemi këtu projektin dhe ta shofim se si duket ajo pjesë.

Labinot Shahini, ne si grup parlamentar i LDK-së e mbështesim këtë memorandum dhe është shumë e rëndësishme për Komunën e Lipjanit dhe ne si komitet i shërbimeve publike në dhjetor kemi propozue gjelbërimin e hapësirave publike në Lipjan si dhe vendosjen e drunjëve dekorativ, në fundë tha se në këtë projekt investon edhe “Demosi”.

Xhevat Olluri, ky projekt duhet të përkrahet se është në të mirën e qytetarëve . Në vazhdim tha se është mirë që të parashifet edhe një stazë e biciklistëve.

Edita Gashi, është mirë të dihet se kur fillon dhe kur mbaron ky projekt

Florent Hoxha, ky vendim ka gabime gjuhësore dhe teknike andaj është mirë të kontrollohet nga lektori. Në vazhdim tha se ne e kemi planin zhvillimor urban dhe me këtë planë janë të parapara stazat e biciklistëve andaj është mirë që këto staza të përfshihem me këtë projekt. Ne si grup i PDK-së e përkrahim këtë propozim vendim.

Arbëmn Bahtiri, e përshëndes këtë propozim vendim të ekzekutivit dhe kemi kërkesë që njera pjesë e rrugës të shfrytëzohet për parking

Ilir Tasholli, është një pako e punës në mes të demosit dhe Komunës që do të zgjasë 3 vite dhe Komuna ka marr për sipër hartimin e projektit detal që e përmendi Petriti. Kemi pas biseda

esdhe për shtigjet për bicikleta me të gjithë donatorët por konstatimi është se nuk ka mundësi mu bërë këto shtigje.

Me që diskutime të tjera nuk pati Kryesuesja, vuri në votim propozim vendimin dhe pas votimit konstatoi se Kuvendi me 28 vota për asnjë kundër aprovoi këtë :

V E N D I M
PËR MIRATIMIN E MEMORANDUMIT TË MIRËKUPTIMIT PËR BASHKËFINANCIM NË
IMPLEMENTIMIN E PROJEKTIT RREGULLIMI I HAPËSIRAVE PUBLIKE NË QYTETIN E
LIPJANIT

Neni 1

Me këtë Vendim, miratohet Memorandumi i Mirëkuptimit i lidhur ndërmjet HSIK-DEMOS dhe Komuna e Lipjanit me datë 18.09.2014, për bashkëfinancimin e projektit: Rregullimi i hapësirave publike në qytetin e Lipjanit që nënkupton: rregullimin e hapësirave publike në kuadër të segmenteve rrugore “Lidhja e Prizrenit”, “Avdi Kelmendi” dhe “Komandant Kumanova” në Lipjan.

Neni 2

Projekti do të implementohet nga Helvetas Swiss Intercooperation , Kosovë në kuadër të Programit për Decentralizim dhe Përkrahje të Komunave - “HSIK-DEMOS”.

Neni 3

Shuma e bashkëfinancimit do të jetë 45.000.00€ nga HSIK-DEMOS kurse Komuna e Lipjanit do të bashkëfinancoj me 55% të vlerës së përgjithshme të projektit përkatësisht 55.000.00€, që rezulton në kosto totale të projektit në lartësi prej 100.000.00€.

Neni 4

Procesi i implementimit të projektit do të realizohet përmes procedurës së prokurimit publik në bashkëpunim me autoritetet përgjegjëse nga DEMOS dhe nga Komuna e Lipjanit.

Neni 5

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Zyra e Kryetarit të Komunës, Drejtorati për Buxhet dhe Financa dhe Drejtoratet relevante që involvohen në këtë process.

Neni 6

Ky Vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokolit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal dhe publikimit në Web faqen e Komunës dhe më të njëjtin do të njoftohen autoritetet përgjegjëse nga DEMOS.

Pasi çështje të tjera nuk pati mbleldhja përfundoi në ora 12,15

Ekstraktin e hartoi
Sami Murati

Kryesuesja e Kuvendit
Vlora Limani-Hajnuni